

**TRAJTIMI I STUDENTEVE SH A
GJIROKASTER
K43128662E**

SHENIME SHPJEGUESE
(PASQYRAT FINANCIARE 2020)

**A.KUADRI KONTABEL I APLIKUAR SI DHE PERSHKRIMI I POLITIKAVE KRYESORE
KONTABLE TE PERDORURA PER PERGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE**

a. -Menyra e Pergatitjes se Pasqyrave Financiare

P F te shoqerise jane pergatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me SKK, te cilat perfshijne rregullat e percaktuara ne ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin 9477 date 09.02.2006 dhe ne "Standartet Kombetare te Kontabilitetit" (SKK) te permiresuara

Pasqyrat Financiare jane pergatitur duke ndjekur e zbatuar Politikat Kryesore Kontabel si : politika per njohjen e aktiveve,e detyrimeve , e te drejtave ,e te ardhurave e shpenzimeve si dhe vleresimin e tyre. Gjithashtu gjate pergatitjes se Pasqyrave Financiare jane pasur parasysh Parimet e meposhteme :

Parimi i te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara,

Parimi i Njesise Ekonomike Raportuese,

Parimi i vijimesise se veprimtarise ekonomike si dhe Parimi i Kompesimit.

Karakteristikat cilesore te pergatitjes se Pasqyrave Financiare jane ato qe e bejne informacionin e dobishem per perdoruesin.

Karakteristikat kryesore qe jane mbajtur parasysh gjate hartimit te Pasqyrave Financiare jane : Kuptueshmeria,Rendesia , Materialiteti,Besueshmeria dhe Krahueshmeria.

b. Rregullat per vleresimin Mjeteve Monetare

Mjetet monetare perfaqesojne Likujditetet e njesise ekonomike ne arke dhe ne banke ,ne llogari rrjedhese ,investime ne tregun e parase dhe tregje te tjera shume likuide duke ndjekur politiken kontabel te Vleres se drejte ne zbatim te SKK 3.

c. Rregullat per vleresimin e Aktiveve te tjera financiare afatshkurtera

Aktiveve te tjera financiare afatshkurtera ,kerkesa te arketueshme afatshkurtera letra me vlere dhe investime te tjera financiare jane te pasqyruara mbi bazen e vleres se faturave origjinale te leshuara klienteve apo te dokumentave te tjere kontabel.Politika kontabel e ndjekur per aktivet financiare afatshkurtera eshte sipas Kosos se amortizuar qe eshte e barabarte me vleren nominale te kerkeses per arketim minus zhvleresimin n.q.s. ka) sipas SKK 3.

d. Rregullat per vleresimin e Gjendjeve te Inventarit

Menyra e Vleresimit te Inventareve permbledh shpenzimet e blerjes se lendeve te para,mallrave e materialeve ,shpenzimet e transportit,dhe shpenzimet e tjera deri ne magazinimin e tyre .



e. Rregullat per vleresimin e Aktiveve afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale te ndara ne zerat si toka,ndertesa,makineri e paisje,paisje zyre e informatike te klasifikuara sipas SKK 5 jane perfshire ne pasqyrat financiare duke ndjekur politiken kontabel Kosto e blerjes ose prodhimit ose shuma e rivleresuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin nqs ka.Metoda e llogaritjes se Amortizimeve behet ne zbatim te ligjit nr 8438 date 28 12.1998 per normat e amortizimit .

Baza e llogaritjes mbi vleren neto kontabel .

Llogaritja e amortizimit per AAM te hyra gjate vitit eshte bere duke filluar nga data 1 e muajit pasardhes.

- Per ndertesat me 0,1 % te vlefes se mbetur .
- Makineri e paisje – kaldaja me 5% te vlefes se mbetur.
- Kompjutera e sisteme informacioni me 5 % te vlefes se mbetur.
- Mobilje dhe orendi me 5 % te vlefes se mbetur .
- Mjete transporti me 5 % te vlefes se mbetur .
- Instrumenta dhe vegla pune me 5% te vleres se mbetur .

f. Rregullat per vleresimin e Huave e Parapagimeve

Huate dhe parapagimet te klasifikuara sipas zerave te pagueshme ndaj furnitoreve,ndaj punonjesve,detyrime tatimore,hua te tjera jane vleresuar sipas faturave te blerjes e dokumentave te tjere origjinale kontabel , sipas SKK 3.

g. Rregullat per vleresimin e Kapitalit

Kapitali i njesise ekonomike vleresohet sipas vleres kontabel te kapitalit aksionar te emetuar ne krijim te njesise ekonomike,rezervave te krijuara ne perputhje me statutin e njesise ekonomike,ne perputhje me kerkesat e ligjit “Per shoqerite Tregtare” ose ndonje ligj tjeter te aplikueshem,Fitimet e pashperndara te ndikuara nga ndikimet ne politikat kontabel (skk 1)korigjimi i gabimeve si dhe rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale(SKK 5).

Fitimi ose humbja e vitit financiar eshte e barabarte me fitimin ose humbjen e raportuar ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve .

Humbja e vitit 2019 eshte mbartur per vitin 2020 .

h. Rregullat e vleresimit te te Ardhurave

Te ardhurat perfaqesojne shitjet neto e rrjedhimisht te ardhurat e perfuara nga akomodimi i studenteve ne konvikt ,nga qiradhenia , si dhe nga rishitja e energjise elektrike gjate periudhes kontabel te vleresuara sipas SKK .

Rregjistrimi eshte bere sipas mases se realizimit te tyre dhe te lidhjes qe kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pavaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes .

i. Rregullat e vleresimit te Shpenzimeve direkte



17.01

Shpenzimet e njesise ekonomike te vitit financiar perfaqesojne shpenzimet e blerjes te mallrave, lendeve te para dhe sherbimeve te konsumuara per veprimtarine paresore ,koston e sherbimeve kryesore te vleresuara me cmimet e blerjes e te vertetuara me fatura origjinale e dokumenta te tjera kontabel, shpenzime qe lidhen ne menyre direkte me sherbimin e ofruar .

Pagat shperblimet dhe kompesimet monetare ,sigurimet shoqerore te paguara nga njesia ekonomike te llogaritura mbi pagat qe i perkasin periudhes kontabel pavaresisht nga fakti nese ato jane paguar ose jo. Shpenzimet per amortizimin qe vijne nga renia ne vlere e aktiveve afatgjata. Shpenzimet e tjera qe jane shpenzimet e tjera te pa perfshira ne zerat e mesiperme por qe lidhen me veprimtarine kryesore te njesise ekonomike.

j. Organizimi kontabilitetit

Kontabiliteti eshte i organizuar ne perputhje me ligjin nr 9228 date 29 04 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin nr 9477 date 09.02.2006. dhe me SKK 2 . Shoqeria ka ndertuar nje plan te llogarive vetjake ne perputhje e ne zbatim te SKKe permiresuara.

B. SHPJEGIME MBI DISA ZERA TE BILANCIT

► Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

Pasqyrat financiare jane parqitur ne menyre analitike prandaj po bejme nje shpjegim te shkurter rreth pasqyrave

► Aktivet Afatshkurtra perbehen nga :

► 1-Aktivet monetare 3 027 205 leke

-mjete monetare ne banke **3 027 205 leke**

Shoqeria kryen transaksione vetem nepermjet bankes , nuk vepron me arke .

Ne postin mjete monetare ne banke, gjendja e bankave perputhet me gjendjen e bankes ne bilanc.

Shoqeria operon ne dy banka , Raiffesen Banke dhe Abi banke .Transaksionet e kryera jane te pasqyruara .

Kontabilizimi i bankave eshte bere rregullisht . Gjendja e bankave ne fund te vitit kuadron me shifrat e bilancit .

► 2-Te drejta te arketushme

Ne aktivitetin e shfrytezimit

a. -Klientet 0 leke

Shoqeria i ka klientet analitike . Dhe nuk ka kliente te dyshimte.

b. Debitor kontrolli - Personeli 2,824,020 leke

Kjo eshte shume e mbartur nga viti 2017 , e cila paraqet terheqje nga banka por te pa dokumentuar me dokumentacion arke . Ne shoqeri mungojne mandat arketimet dhe mandat pagesat si dhe



[Handwritten signature]

dokumentat shoqerues qe te vertetojne shpenzimet e mundshme te shumave te terhequra nga banka , mbartur nga viti 2017 .

Shoqeria i eshte drejtuar organeve te drejtesise per te sqaruar situaten.

c. Debitor kontrolli - kerkesa te tjera 553,526 leke

Kjo shume paraqet detyrime te nxjerra me urdher zhdemtimi sipas auditit te kryer ne shoqeri ne vitin 2014.

d. Debitor te tjere – 3,589,107 leke .Kjo shume paraqet detyrime te nxjerra nga auditit i realizuar ne Shoqeri ne vitin 2018 .

3-Inventari - 1,097,880 leke nga te cilat :

Shuma **191,037 leke** jane materiale pastrimi dhe disifektimi ,

Shuma **316,318 leke** jane materiale elektrike,hidraulike etj ,

Shuma **324,497 leke** lende djegese

Shuma **65,906 leke** jane kancelari

Shuma **200,122 leke** jane materiale te tjera, material ndertimi.

Total i Aktiveve Afatshkurtera eshte 11,091,738 leke .

► **Aktivet e Afatgjata**

4-Kliente aftgjate-0

► **5-Aktivet Materiale**

Shoqeria ka ne bilanc **804,418,567 leke** Aktive Afatgjata Materiale .

Ne bilanc jane paraqitur me vleren neto duke zbritur nga kostua historike amortizimin e akumuluar deri ne 31.12.2020.

Me konkretisht :

Ndertesa me vlere neto **790,049,669 leke** .

Vlera fillestare eshte — **1,096,131,213** .

Vlera bruto me 31.12.2020— **1,096,131,213** (zbritet amortizimi i akumuluar -306,081,544)

Makineri , paisje-Kaldaja me vlere neto **5,329,480 leke** .

(vlera fillestare 8,403,808 minus amortizimin e akumuluar (-3,074,328) .

Instrumenta / vegla pune me vlere neto 143,963 leke .

Vlera fillestare 163,305 leke minus amortizimin e akumuluar (-19,342) leke .

Mjete transporti me vlere neto **527,524 leke** .

(vlera fillestare **3,154,000** - amortizimin e akumuluar (-2,626,476) .

Te tjera instalime dhe ndertime me vlere neto **4,668,116 leke** .

Vlera bruto eshte 5,145,877 leke .

Vlera bruto **5,145,877 leke** (zbritet amortizimi —477,761 .)

Mobilje dhe paisje zyre me vlere neto **3,273,130 leke** .

Vlera fillestare ne fillim te vitit 2020 ishte **21,353,584 leke** - amortizim i akumuluar **(18,080,454)** .

Pajisje informatike me vlere neto **426,685 leke** .

Vlera fillestare ne fillim te vitit 2020 ishte 944,166 leke .

Vlera bruto 944,166 leke - amortizimi (517,481)

Aktive Afatgjata ne proces-0



Totali i Aktiveve Afatgjata eshte 804,418,567 leke .

Ne total Aktivi per vitin 2020 eshte 815,510,304 leke .

Në bilancin e vitit ushtrimor 2020 nuk kemi paraqitur investimin që përfshin rikonstruksionin e godinës së konviktit të djemve. Investimi në formë donacioni filloi në muajin Nëntor të vitit 2019, dhe përfundoi në muajin Qershor të vitit 2020. Firma turke "Tika" e cila realizoi rikonstruksionin e kësaj godine nuk ka sjellë në institucionin tonë asnjë lloj dokumenti që filloi rikonstruksionin, apo dokumenta të tjera si: kontratë, dokument të marrjes në dorëzim të godinës së vjetër, situacion punimesh, fatura për vlerën e investimit, dokumenta për dorëzimin e këtij investimi të rikonstruktuar.

► Detyrimet dhe Kapitali

► Detyrimet afatshkurtra

1-Titujt e huamarrjes-0

2- Te pagueshme ndaj furnitoreve 2,415,368 leke .

Kjo shume perfshin detyrimet e muajit Dhjetor 2020 ndaj :

Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster ne shumen 24,944 leke

Posta Shqiptare ne shumen 195 leke

Luan Muça (ekspert kontabel) ne shumen 180,000 leke

Eneda Rahmani (ekspert kontabel) ne shumen 180,000 leke

OSHEE per vitin 2020 ne shumen 2,030,229 leke .

- Llogari bankare te zbuluara (overdraftet)---0

3- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Siguracion i studenteve --- 42,000 leke , krijuar ne vitin 2020.

4- Të pagueshme ndaj punonjesve ,sigurimeve shoqërore/shëndetësore

Sig Shoqer + Shendet dhe T.A.Punesimi 252,275 leke

5- Të pagueshme për detyrimet tatimore :

Tatim ne Burim 10,704 leke

Te tjera tatime per tu paguar dhe per tu kthyer / Taksa bashkia 270,000 leke .

Detyrimet afatshkurtra per vitin 2020 jane ne shumen 2,990,348 leke .

► Detyrimet Afatgjata- ne shumen 26,496,803 leke nga te cilat :

Detyrime te mbartura ndaj F.SH.U ne shumen 24,925,310 leke .

Detyrime te mbartura ndaj "Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster" Sh.a ne shumen 1,475,519 leke .

Detyrim per garanci difektesh per situacione punimesh "Colombo " ne shumen 95.974 leke .

Detyrimet totale per vitin 2020 jane ne Shumen 29,487,151 leke .

► Kapitali dhe rezervat :

Perbehet nga:

1-Kapitali aksionar 727,244,000 leke

2-Rezerva rivleresimi 105,828,637 leke

3-Humbje mbartur -40,241,093 leke

4- Humbje vitit ushtrimor -6,808,391 leke

Total i Kapitalit eshte 786,023,153 leke .



Total i Pasivit per vitin 2020 eshte 815,510,304 leke .

► Pasqyra e Performances :

Te ardhurat kane ardhur kryesisht nga pagesat per akomodim nga studentet ne rrjedhen normale te shoqerise .

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte paraqitur ne menyre analitike prandaj po japim nje shpjegim te shkurter .

► Te ardhura nga aktiviteti shfrytezimit 14,590,500

<i>Te ardhura nga Aktiviteti I shfrytezimit</i>	<i>1,141,500 leke</i>
<i>Te ardhura te tjera te shfrytezimit/Energji elektrike</i>	<i>0 leke</i>
<i>Te ardhura nga Qiraja</i>	<i>0 leke</i>
<i>Subvencione te shfrytezimit</i>	<i>13,449,000 leke</i>

► <u>Shpenzime per Materiale e Mallra</u>	4,878,218 leke.
• Blerje energji avull ne shumen	4,968,992 leke
• Lende te para materiale ne shumen	90,774 leke

► Shpenzime të personelit 11,935,709 leke :

- *Pagat dhe shperblimet e personelit* 10,265,321 leke
- *Sigurime shoqerore dhe shendetsore* 1,664,888 leke
- *Shpenzim dieta ne shumen* 5,500 leke

► Shpenzime konsumi dhe amortizimi

- *Amortizime te Aktiveve Afatgjata* 1,544,740 leke

► Shpenzime të tjera shfrytëzimi 3,477,920 leke :

Blerje të pastokueshme	355,120 leke
Punime dhe lyerje	467,380 leke.
Karburanti, lende djegese	437,513 leke
Nëntrajtime të përgjithshme	334,200 leke
Mirëmbajtje dhe riparime	3,000 leke
Prime të sigurimit	20,900 leke
Të ndryshme	471,190 leke
Personel nga jashtë njësisë ekonomike	360,000 leke
Shperblim bordi	812,740 leke
Shpenzime postare dhe telekom	96,515 leke
Shërbime bankare	18,173 leke
Tatime e taksa te tjera	101,189 leke
Shpenzime Gjore ne shumen	15,000 leke

- **Të ardhura nga garanci te mbajtura studenteve per vitet paraardhese ne Shumen 452,696 leke.**



► Fitimi/Humbja para tatimit

-6,808,391 leke

► Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
(metoda direkte)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare është paraqitur e detajuar .
Levizja e parave perbehet kryesisht nga :

► Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit

Mjetet monetare te arketuara nga klientet	1,181,500 leke:
• M.monetare te arketuara nga klient student	1,181,500 leke
M. Monetare te arketuara si Subvencione	13,449,000 leke
M.M të paguara për detyrimet e pagueshme furnitor	-3,982,881 leke
M.M paga dhe shperblime	-8,677,964 leke
M.M. te paguara per shperdlime punonjesish	-133,977 leke.
M.M Sigurime shoqerore dhe shendetsore	-3,297,524 leke
M.M të ndryshme	-390,140 leke
M.M personel nga jashtë njësisë ekonomike (Shperblim bordi)	-690,829 leke
M.M Transferime, udhëtim e dieta	-5,500 leke
M.M shërbime bankare	-18,173 leke
M.M tatime e taksa, derdhje të ngjash të lidhura	-101,189 leke
M.M kthim garancie qeramarresi	-60,000 leke
M.M penalitete, gjoha e dëmshpërblime	-15,000 leke

- Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar ne Shumen 5,767,881 leke.
- Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor ne shumen 3,027,205 leke

F.VAZHDIMESIA E SHOQERISE

Shoqeria mendon se ne te ardhmen do te rrise me tej aktivitetin e saj ekonomik, dhe per rrjedhoje Kapitalet e veta .

Specialiste Finance

Jona Kardhashi



Gjirokastër më 19.03.2021

Administrator

Klodjan MICKA

